



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MUNDËSI APLIKIMI PRANË UNIVERSITETIT KOMBËTAR

“KAPODISTRIAN” TË ATHINËS, VITI AKADEMIK 2020-2021

Universiteti Kombëtar “Kapodistrian” i Athinës për vitin akademik 2020-2021 shpall thirrjen për aplikime për kandidatët e huaj për në programe studimi Bachelor në fushat e arkeologjisë, historisë dhe letërsisë së Greqisë antike.

Kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë nëpërmjet sistemit online, i cili është i hapur deri në datën 31 mars 2020 (afati i fundit për aplikim).

Ky është programi i parë i diplomës Bachelor që mësohet në gjuhën angleze në një universitet grek dhe ndërthur në një sintezë unike disiplinat në fushat e arkeologjisë, historisë antike dhe letërsisë antike greke.

Kurrikula e programit përfshin të gjitha aspektet e studimeve të lashta greke, të përshtatura për një audiencë globale me një interes për kulturën klasike. Programi u drejtohet vetëm kandidatëve nga vendet jo anëtare të Bashkimit Evropian.

Programi BA në Arkeologji, Histori dhe Letërsinë e Greqisë antike ka në fokus antikitetin Grek dhe i pajis studentët me një diplomë Bachelor në Arte (BA).

Broshura elektronike e programit dhe informacione të tjera gjenden në adresat e mëposhtme web:

<https://baag.uoa.gr>;

<https://baag.uoa.gr/application/>;

https://synergasia.uoa.gr/modules/document/file.php/ADM102/Parousiasi_A4_School_of_Philosophy.pdf;

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE

ASISTENCËS